



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.03.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", e Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V E R E N**

Kryetari i Bashkisë, në zbatim të neneve 62, pika 4, dhe 93, pika 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, në rast të pamundësisë të caktimit të vendndodhjes së QV-së në ndërtesë publike, brenda territorit të qendrës së votimit, apo në zonë votimi fqinje, ka detyrimin t'i propozojë KQZ-së propozimin për caktimin e QV në ndërtesë private.

Kryetarët e Bashkive Vau Dejës, Lezhë, Kurbin, Bulqizë, Durrës, Shijak, Belsh, Gramsh, Cërrik, Elbasan, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Divjakë, Mallakastër, Tepelenë, Devoll, Selenicë, Lushnje kanë paraqitur propozimet dhe dokumentacionin përkatës për caktimin e



**Nr.106 i Vendimit**

**Data 27.03.2019**

**Ora 12:00 e Vendimit**

Per caktimin e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

151 QV në ndërtesa private. Në analizë të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, mungesa e objekteve publike është shkak për propozimin e caktimit të vendndodhjes së QV-ve në ndërtesa private. Propozimet janë shoqëruar me të dhëna dhe dokumentacion në përputhje me përcaktimet e nenit 93, pika 3, të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimin e KQZ-së Nr.1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet". Pjesa më e madhe e këtyre qendrave të votimit kanë qenë në objekte private dhe në zgjedhjet pararendëse.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

### **V E N D O S I**

1. Caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes Nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë lajmërimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

